



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/70
Datë: 21.04.2022

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 21 prill 2022, merr këtë:

V E N D I M

1. Qeveria e Republikës së Kosovës, në pajtim me Përfundimin e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.08-P-042 të datës 21 mars 2022, jep mendim lidhur me Nismën legislative për Projektligjin për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr.04L-101 për Fondet Pensionale të Kosovës, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr.04/L- 115, me Ligjin Nr.04/L- 168 dhe Ligjin Nr.05/L-116.
2. Qeveria e Republikës së Kosovës nuk vlerëson Nismën legislative të iniciuar nga deputetët propozues të Kuvendit të Republikës së Kosovës për miratimin e Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr.04L-101 për Fondet Pensionale të Kosovës, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr.04/L- 115, me Ligjin Nr.04/L- 168 dhe Ligjin Nr.05/L-116, si të nevojshme.
3. Qeveria e Republikës së Kosovës është afër qytetarëve, për të ndihmuar përmes rishpërndarjes, rritjes së punësimit, rritjes së mbështetjes në skemat sociale, fëmijëve, grave dhe të rinjve, si dhe fermerëve e ndërmarrësisë së vogël e të mesme. Tërheqja nga Trusti nuk ndihmon kategoritë në nevojë, pasi vetë përqindja e fondit pensional të tyre është e ulët. Me kursimin e pleqërisë nuk duhet abuzuar dhe veprimin e atillë, duhet konsideruar si të mangët.
4. Nisur nga kjo që u tha më lart, Qeveria e Republikës së Kosovës nuk përkrah iniciativën e deputetëve nënshkrues të nismës legislative, të përshkruar si në pikën 2. të këtij Vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë